



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Mirëqenies Sociale
dhe Rinisë

Nr. 5764 datë 7.10.2016

Ministria e Shëndetësisë

Nr. 5110 datë 10/10/2016

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 21, datë 07.10.2016

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL TË AFTËSISË SË KUFIZUAR TEK TË RRRITURIT DHE FËMIJËT NË ZONAT PILOT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 42/3 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, pikës 2 të Kreut III të Vendimit nr. 431, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”,

UDHËZOJMË

1. Miratimin e Kriterëve të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek të Rriturit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
2. Miratimin e Kriterëve të Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek Fëmijët, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Udhëzimi.
3. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, strukturat e shërbimit shëndetësor parësor dhe dytësor, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, për zbatimin e këtij Udhëzimi për zonat pilot.

Ky Udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

BLENDI KLËSI



MINISTRI I SHËNDETËSISË

ILIR BEQAJ

